

TRAJNIMET E ODES EKONOMIKE TE KOSOVES

MUNDËSI PËR TRAJNIM ME PAGESË PËR PERSONAT E PAPUNË

Objektivi i thirrjes: Përzgjedhja e punëdhënësve nga sektorët e turizmit, hotelierisë dhe sektorëve të ndërlidhur, të cilët do të marrin pjesë në një program trajnimi me pagesë tre mujore në vendin e punës për gjithsej 15 kandidatë të përzgjedhur me thirrje publike, me mbështetjen e Odës Ekonomike të Kosovës dhe ETRI.

👤 Kush ka të drejtë të aplikojë: Punëdhënës nga turizmi, hoteleria dhe sektorët përkatës, nga komunat në vijim: Pejë, Istog, Klinë, Junik, Deçan dhe Gjakovë.

📅 Koha e trajnimit: 15 tetor – 15 janar 2024

🕒 Afati i aplikimit: Aplikimet për trajnim në punë janë të hapura nga data 08 – 23 korrik 2023.

Aplikoni:

<https://forms.gle/qo7kZcLNBfgfQV7s8>

**TRAJNIM
TURIZËM, HOTELERI &
SEKTORË TË NGJASHËM**

15 TETOR 2023
15 JANAR 2024

APLIKO TANI

OEK-KCC.ORG

THIRRJE PËR APLIKIM NË TRAJNIMIN: INSTRUKTOR NË VENDIN E PUNËS 🧑🏫🏢 Grupi 2

Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) me mbështetjen e Qeverisë Gjermane përmes GIZ Kosova, organizon trajnimin “Instruktor në vendin e punës” me ç’rast fton të gjitha kompanitë e interesuara të cilat plotësojnë kriteret e poshtëshënuara të aplikojnë.

Cili është qëllimi i trajnimit?

Trajnimi ka për qëllim t’iu ofrojë pjesëmarrësve teknika dhe mjete udhëzuese për të menaxhuar dhe motivuar performancën e një praktikanti/e apo punëtori/e duke përdorur një mori kompetencash, motivim pozitiv dhe vlerësim të vazhdueshëm për diagnostikimin e mangësive të aftësive të kandidatëve, si dhe zbatimin e strategjive të përmirësimit të këtyre aftësive në kohën e duhur.

Me anë të këtij trajnimi ju do të përfitoni kompetenca të cilat do të ofrohen përmes një kombinimi të leksioneve ndërvepruese, studimeve të rasteve, aktiviteteve simuluese të trajnimit në punë, diskutimeve për zgjidhjen e problemeve dhe praktikës. Pjesëmarrësit fitojnë një mori mjetesh dhe njohurish, aftësish që do t’iu ndihmojnë atyre rolin e ri, si instruktor në vendit të punës që mund të marrin përsipër në kompanitë e tyre.

Trajnimi është intensiv dhe zgjatë 3 ditë. Në trajnim do të mund të marrin pjesë 20 përfitues.

Shënim: Kompanitë që aplikojnë të parat dhe plotësojnë kriteret e mëposhtme do të ftohen të marrin pjesë në trajnimet. Në trajnim do të ftoheni sipas parimit First In, First Served

Kush mund të përfitoj?

- Të gjithë të punësuarit që delegohen nga kompania.
- Të gjithë të punësuarit që kanë pozitë udhëheqëse apo punojnë në burimet njerëzore.
- Të gjithë të punësuarit që janë përgjegjës për orientimin dhe monitorimin e praktikantëve në kompani.
- Kompanitë që janë të interesuara të certifikohen me vlen e ekselencës e të mësuarit në vend të punës (Seal of Excellence of WBL).

🔗 Si të aplikoni?

Për të aplikuar për pjesëmarrje në trajnim, ju lutem shkoni në këtë link:

🔗 <https://forms.gle/RghTU6u36qWEniXGA> dhe plotësoni formularin, deri më datën: 4.7.2023

Shënim: Aplikimi nuk mund të bëhet në mënyrë individuale, por kandidati duhet të delegohet nga kompania. Aplikacionet të cilat nuk janë të plotësuara në tërësi, nuk do të merret parasysh.

📍 Ku dhe kur do të mbahen trajnimet?

Trajnimet planifikohet të mbahet në formë fizike në hapësirat e Odës Ekonomike të Kosovës (OEK) me datë 7–9 korrik. Vetëm kandidatët (e deleguar nga kompanitë), e përzgjedhur do të lajmërohen përmes emailit dhe SMS-ve deri më datën 5.7.2023. Më shumë informata: 045 639 444

APLIKIMI ËSHTË I HAPUR NGA 26.6.2023



TRAJNIM PA PAGESË INSTRUKTOR NË VENDIN E PUNËS **GRUPI 2**



Oda Ekonomike e Kosovës



7 - 9 korrik



20 Përfitues

[Apliko Tani](#)

MVP

Të Mësuarit në
Vendin e Punës

Trajnim një ditor - Parimet e Qeverisjes Korporative në NVM dhe Biznese Familjare

Ju njoftojmë se Oda Ekonomike e Kosovës në bashkëpunim me RECURA financials, organizon trajnimin Parimet e Qeverisjes Korporative në NVM dhe Biznese Familjare me ç'rast fton të gjitha kompanitë e interesuara të aplikojnë

- **Qëllimi i trajnimit**

Qëllimi i trajnimit për qeverisjen e korporatave është të edukojë dhe trajnojë individët brenda një kompanie mbi parimet, praktikën më të mira dhe përgjegjësitë që lidhen me qeverisjen e korporatave. Qeverisja e korporatave i referohet sistemit të rregullave, praktikave dhe proceseve me të cilat drejtohet dhe kontrollohet një kompani. Kjo përfshin marrëdhëniet ndërmjet menaxhmentit të kompanisë, bordit të drejtorëve, aksionarëve dhe palëve të tjera të interesuara.

Trajnimi synon të përmirësojë të kuptuarit e parimeve të qeverisjes korporative dhe zbatimin e tyre brenda kompanive.

Qëllimet kryesore të trajnimit për qeverisjen e korporatës përfshijnë

- Promovimi dhe ndërgjegjësimi i praktikave të qeverisjes korporative
- Sigurimi i pajtueshmërisë ligjore
- Përmirësimi i vendimmarrjes
- Rritja e efektivitetit të menaxhmentit
- Zvogëlimi i rreziqeve
- Ngritja e besimit dhe reputacionit
- Nxitja e qëndrueshmërisë afatgjate

Modulet e trajnimit

Modulet e trajnimit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme si dhe të mëdha përfshijnë, por nuk kufizohen në temat e mëposhtme

- Praktikën e mira të qeverisjes në biznesin familjar
- Rritja e strukturës organizative
- Përmirësimi i procesit të vendimmarrjes
- Zhvillimi i strategjisë
- Planifikimi i vazhdimësisë
- Kuptimi i proceseve bazë të kontrollit të brendshëm
- Parimet e transparencës dhe zbulimit
- Balanca gjinore / Diversiteti dhe menaxhimi i ndjeshëm ndaj gjinisë

Kushtet e pjesëmarrjes

Trajnimi është i dizajnuar për kandidatë të cilët plotësojnë kërkesat e parapara, përshkruar si poshtë

- Te jenë pronarë apo bashkëpronarë të kompanive

- Të jenë drejtues te larte te kompanive apo edhe anëtare të familjes (trashëgimtarë potencial), pronare te bizneseve.

 Kohëzgjatja e trajnimit do të jetë 2+2 (ose 4 + 4) orë ligjërimit.

Si të aplikoni?

Për të aplikuar për pjesëmarrje në trajnim, ju lutem shkoni në këtë link:

 <https://forms.gle/xXeBe6wBo1RoDqeC7> dhe plotësoni formularin

 PAGESA PËR TRAJNIM: 120€ (10% zbritje për kandidatët që marrin pjesë nga bizneset anëtare të Odës Ekonomike të Kosovës).

 Oda Ekonomike e Kosovës / Kosova Chamber of Commerce

Nëna Terezë, Nr.20, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

 Trajnimi fillon me rastin e formimit të grupit.



The graphic features a light blue background with several upward-pointing arrows of varying shades. In the top right corner is the logo of the Kosovo Chamber of Commerce, which includes a sun, stars, and a green field. The main title is in large, bold, teal letters: "TRAJNIM NJË DITOR PARIMET E QEVERISJES KORPORATIVE NË NVM DHE BIZNESE FAMILJARE". Below the title, there are two icons: a location pin and a person icon, followed by the text "Oda Ekonomike e Kosovës" and "Trajnimi fillon me rastin e formimit të grupit." At the bottom left, there is a dark teal button with the white text "APLIKO TANI". At the bottom right, the website address "www.oek-kcc.org" is displayed.

EKSPERT TË SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË

✓ Trajnimi "Ekspert i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë" ka për qëllim të ofroj njohuri mbi fushën e sigurisë në punë, mbi rreziqet dhe menaxhimin e tyre në vendin e punës. Trajnimi gjithsej përmban 150 orë [120 orë teori dhe 30 orë praktike].

 Modulet e trajnimit:

- Sistemi themelor i SSHP-se dhe kërkesat ligjore, mbikëqyrja shtetërore;
- Grupet e faktorëve të riskut në vendin e punës dhe aktet përkatëse ligjore;
- Faktorët e riskut të lidhur me lëndimet (traumatike);
- Faktorët e riskut fizik;
- Faktorët e riskut të kimikateve dhe pluhurit;
- Faktorët e riskut ergonomik;
- Faktorët e riskut biologjik;
- Faktorët e riskut psiko-social;
- Parandalimi i faktorëve të riskut në vendin e punës;
- Vlerësimi i riskut në vendin e punës;
- Aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale;
- Ndihma e parë dhe planifikimi i emergjencave;
- Marrëdhëniet ligjore të punës;
- Kërkesat specifike të SSHP-së për industritë me risk të lartë;
- Inspektimi në vendin e punës;
- Punë praktike.

 Kandidatët e interesuar për t'u certifikuar si ekspert për sigurinë dhe shëndetin në punë, duhet të plotesojnë kushtet dhe kriteret e mëposhtme:


Kandidati ka një diplomë universiteti në shkencat teknike, biologji, kimi, fizikë, juridik, psikologji, mjekësi dhe fusha të tjera të ngjashme;

Kandidati me kualifikime nga shkencat teknike duhet të ketë së paku një (1) vit përvojë pune në sigurinë dhe shëndetin në punë, ose së paku dy (2) vite përvojë pune të përgjithshme;

Kandidati nga fushat e tjera duhet të ketë së paku tre (3) vite përvojë në sigurinë dhe shëndetin në punë, ose së paku pesë (5) vite përvojë pune të përgjithshme;

 Lokacioni: Oda Ekonomike e Kosovës/ Kosova Chamber of Commerce

Nëna Terezë, Nr.20, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

 Pagesa për trajnim: 450€ (10% zbritje për kandidatët që marrin pjesë nga bizneset anëtare të Odës Ekonomike të Kosovës).

 Trajnimi fillon me rastin e formimit të grupit.




ODA EKONOMIKE E KOSOVËS / KOSOVA CHAMBER OF COMMERCE

CERTIFIKIM
EKSPERT I SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË

Licensuar nga


Republika e Kosovës
Ministria e Financave, Planit dhe Tregëtisë